



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

KRYETARE

Nr. 481/1 Prot.

Shkodër, më 04.01.2023

V E N D I M

Nr.18, Datë 28.12.2023

“Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2024, per Këshillin e Qarkut Shkodër”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, me propozim të Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër, “Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2024, për Këshillin e Qarkut Shkodër”, Bazuar në Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006, Për sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar, bazuar në nenin 5 pika 4, neni 38 pika ç, neni 77 germa f, neni 78, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 54,55 të ligjit nr.107/2014”Për planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 21 të ligjit nr. 68/2017 ”Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Ligjin nr. 97, datë 07.12.2023 “Per Buxhetin e Vitit 2024” Urdhërit nr.183, datë 26.05.2011 “Për tarifat e shërbimeve që kryhen nga DAMT në qarqe”, Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **15 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**,

V E N D O S I :

1-Të miratojë këto **Tarifa Shërbimesh** në Këshillin e Qarkut Shkodër, për shërbimet që do të kryhen ndaj të tretëve për vitin 2024, si më poshtë:

I	Spektori i Planifikimit dhe zhvillimit territorial	Tarifa (lekë)
1	Nxjerrje e dokumenteve arshivore (1 faqe A4)	300
2	Nxjerrje e dokumenteve arshivore (1 faqe A3)	600

3	Nxjerrje dokumente të konfirmuara për leje ndertimi (dosje complete)	5,000
4	Konfirmim harta pronësie, viti 1962-1981.	1,000
5	Printim i hartave , format A 0	4,000
6	Printim i hartave , format A 1	2,000
7	Printim i hartave , format A 2	1,000
II	Sektori i Sherbimeve Brendshme	
1	Nxjerrje dokumente arshivore (1 faqe A4)	500
III	DAMT	
	Vertetim pronësie para vitit 1946	1,000
	Vertetim pronësie pas vitit 1946	1,000
	Vertetim negativ para reformës , për gjykatë	500
	Vertetim pronësie per ATP	500
	Vertetim pronësie per statusin të pastrehë	200
	Konfirmim Vertetimi per ndihmë ekonomike	100
	Vertetim per kategorizim toke, sipas bonitetit	1,000
	Vertetimi per te dhena Formulari Nr.6	500
	Harta dhe skica planimetrike -kadastrale	1,000

2- Kuota e Antarësisë që Bashkita e qarkut Shkodër i financojnë Këshillit të Qarkut Shkoder për vitin 2024, do të miratohet dhe përfshihet në buxhetin e vitit 2024, pas miratimit të kësaj kuote në këshillat e bashkive respektive.

3-Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjitha Zyrat që ofrojnë keto shërbime .

4- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARE

Marina DUHANI

